

PROCESVERBAL
nga seanca e 7-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 18.2.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Cvetanka Minovska dhe Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: Afrona Vërzivolli (pushime vjetor), Petar Xhurovski (pushim mjekësor).

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunović, mr. Magdalena Davidovska-Dovleva, mr. Argjend Xhelili, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, dr. Ivana Stojanovska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 7-të të Këshillit. Seanca filloi në ora 11:10 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Kryetari Stefanovski, në lidhje me propozimin e rendit të ditës, sqaroi se Pika 3 - "Propozim për inicim të procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TV Edo ShPKNjP fsh. Ljubin, Saraj, për shkelje të nenit 62 të LShMAAV" - renoncohet nga rendi i ditës, sepse subjekti ndërkohë i përmbush kushtet ligjore.

Plotësuese, nga Pika 2 tërhiqet propozimi i tretë për inicim të procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv të TV Shutel nga Shkupi. Me renoncimin e Pikës 3, pikat e mbetura të rendit të ditës do të rinumërohen në mënyrë përkatëse.

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi se Pika 3 tërhiqet nga rendi i ditës sepse ShTR TV Edo ShPKNjP fsh. Ljubin, Saraj i ka përmbushur dispozitat e nenit 62 të LShMAAV, përkatësisht i ka përmbushur kushtet minimale kuadrovice të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovice për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio. Njëkohësisht, propozimi për inicim të procedurës për heqjen e lejes të TV Shutell rinoncohet, duke pasur parasysh se transmetuesi ndërkohë e ka paguar kompensimin vjetor të lejes, në pajtim me faturën e paraqitur për vitin 2026.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi të korrigjuar si më poshtë:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-Procesverbalit të seancës së 6-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 5.2.2026.
2. Propozime për inicim të procedurave për heqjen e lejes për transmetim TV dhe RA të transmetuesve.
3. Propozim-aktvendim për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Televizija Sonce ShPKNJ P Prilep.
4. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: mirëmbajtje parandaluese dhe adaptive e softuerit të integruar për çështje juridike, financiare dhe ekonomike.
5. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: mirëmbajtje e instalimit të spërkatësve kundër zjarrit (nënstacion i thatë, spërkatës dhe pompa) dhe mirëmbajtje e pajisjeve për shuarjen e zjarrit PP.
6. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe, me 4 vota "pro" dhe një votë "abstenim" nga mr. Sasho Stefanovski, miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 6-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 5.2.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Kryetari i Këshillit, Stefanovski, në lidhje me propozimet për iniciimin e procedurave për heqjen e lejeve për transmetim televiziv dhe radio të transmetuesve, propozoi të jepet një shpjegim i përbashkët për të tre propozimet, duke marrë parasysh se ato i referohen të njëjtës dispozitë të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, pas së cilës do të iniciohen shpjegim dhe votim individual.

Drejtori Trajçevski shpjegoi se TV Edo, TV MTM dhe RA 99 nuk kanë shlyer detyrimin financiar ndaj Agjencisë bazuar në kompensimin vjetor për lejen përkatëse. Në pajtim me Ligjin, afati i fundit për pagesë është 30 ditë nga data e dorëzimit të faturës, dhe ky afat ka skaduar. TV Edo ka kryer pagesë të pjesshme prej rreth 90% të shumës totale, ndërsa TV MTM dhe RA 99 nuk kanë kryer asnjë pagesë. Ai shpjegoi më tej se, në pajtim me ligjin, Këshilli duhet të inicon procedurë për heqjen e lejes, e cila u jep transmetuesve një afat shtesë prej 15 ditësh për të shlyer borxhin. Nëse detyrimi shlyhet brenda kësaj periudhe, Këshilli do të marrë aktvendim për ndalimin e procedurës. Përndryshe, është detyrim ligjor të merret vendim për heqjen e lejes së transmetuesve që nuk e kanë shlyer borxhin ndaj Agjencisë.

Kryetari Stefanovski pyeti nëse, para iniciimit të procedurës, shërbimi profesional ka kontaktuar me stacionet televizive dhe radiot me qëllim që t'u kujtojë detyrimin për të paguar, me qëllim që të shmanget heqja e lejes dhe pasojat e mundshme të padëshiruara.

Drejtori Trajçevski sqaroi se jo vetëm këto media, por të gjithë transmetuesit kontaktohen rregullisht në telefon nga Sektori i Financave dhe Logjistikës dhe përkujtohen vazhdimisht për detyrimin ligjor për të paguar kompensimin në kohë.

Votimi për Pikën 2.1

Këshilli i Agjencisë njëzëri inicioi procedurën për heqjen e lejes për transmetim televiziv të TV EDO ShPKNJ P fsh.Ljubin, Saraj, PA1 nr.08-14 datë 7.9.2023, për shkak të mospërmbushjes së detyrimit të nenit 80, paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht nuk ka paguar kompensim vjetor të lejes për transmetim televiziv Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës nr. 2026-100-0008 datë 12.1.2026.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk arrin të paguajë kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të Propozimit për inicim të procedurës për heqjen e lejes, do miraton Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të TV EDO ShPKNJ P fsh.Ljubin, Saraj, PA1 nr.08-14 datë 7.9.2023, për shkelje të nenit 80, paragrafi (5) të LSHMAAV.

Votimi për Pikën 2.2

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka inicuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TV MTM ShPKNJ P Shkup (ShTR Prva Shkup Televizion ShPKNJ P Shkup), PA1 nr. 08-16 datë 7.9.2023, për shkak të mospërmbushjes së detyrimit të nenit 80, paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për transmetim televiziv Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar faturë nr. 2026-100-0010, datë 12.1.2026.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk arrin të paguajë kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të Propozimit për inicim të procedurës për heqjen e lejes, do miraton Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TV MTM ShPKNJ P Shkup (ShTR Prva Skopska Televizija ShPKNJ P Shkup), PA nr.08-16 datë 7.9.2023, për shkelje të nenit 80, paragrafi (5) të LSHMAAV.

Votimi për pikën 2.3

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka inicuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të ShTR Radio 99 ShPKNJ P Shkup, PA1 nr.0802-37 datë 7.2.2024, për shkak të mospërmbushjes së detyrimit të nenit 80, paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për leje të transmetimit në radio të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar faturë nr.2026-100-0026 datë 12.1.2026.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të Propozimit për inicimin e procedurës për heqjen e lejes, do miraton Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të ShTR Radio 99 ShPKNJ P Shkup, PA1 nr. 0802-37 datë 7.2.2024, për shkelje të nenit 80, paragrafi (5) të LSHMAAV.

Pika 3

Drejtori Trajčevski shpjegoi Aktvendimin e propozuar për fshirjen nga Regjistri i Radiodifuzerëve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Televizija Sonce ShPKNJ P – Prilep. Ai shpjegoi se kjo procedurë rrjedh nga vendimi i miratuar më parë i Këshillit për heqjen e lejes së këtij radiodifuzeri, i cili që nga 10 dhjetori i vitit të kaluar ka ndërprerë transmetimin e programit. Në pajtim me ligjin, pas heqjes së lejes, Këshilli është i detyruar të marrë aktvendim për fshirjen e radiodifuzerit nga regjistri i udhëhequr nga Agjencia. Duke vepruar kështu, ai theksoi se pika e propozuar ka karakter teknik.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Televizija Sonce ShPKNJ P Prilep.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 4

Drejtori Trajčevski shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për zbatim të procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtje parandaluese dhe adaptive e softuerit të integruar për çështje juridike, financiare dhe ekonomike. Ai shpjegoi se Spektori i Financave dhe Logjistikës dhe Spektori i çështjeve juridike dhe furnizim publik, këtë softuer e shfrytëzon për shumë vite. Softueri është punuar nga firma "Gord Sistemi Servisi" ShPKNJ Shkup, dhe kjo procedurë realizohet me negociata sepse ata zotërojnë kodin burimor dhe ky softuer është punuar prej tyre. Kjo është e nevojshme në mënyrë që sektoret të mund të kryejnë detyrat e përditshme të punës.

Udhëheqësja e Spektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, sqaroi se furnizimi publik në fjalë është parashikuar në Planin vjetor për furnizim publik, dhe mjetet për realizimin e tij janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë.

Duke marrë parasysh që Agjencia nuk zotëron kodin burimor të softuerit të integruar, procedura duhet të kryhet me negociata me Shoqërinë "Gord Sistemi Servisi" ShPKNJ Shkup, e cila zotëron kodin burimor dhe nga e cila Agjencia ka blerë softuerin në vitin 2015. Për këto arsye, furnizimi do të realizohet duke zbatuar procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit. Përveç kësaj, para fillimit të procedurës, përkatësisht para se t'i dërgohet ftesa operatorit ekonomik për të paraqitur ofertë, do të jetë e nevojshme që Byroja për furnizim publik të japë miratimin se në rastin konkret janë përmbushur kushtet ligjore për zbatimin e këtij lloji procedure në pajtim me Ligjin për furnizim publik.

Këshilltarja Zirjeta Jajaga pyeti nëse ka kufizim në lidhje me vlerën (lartësinë) e çmimit të shërbimit, përkatësisht nëse ka limit ligjor apo ndonjë limit tjetër për rritjen e tij.

Udhëheqësja Mitrevska sqaroi se nuk ka ndonjë kufizim formal në lidhje me shumën e mjeteve. Ajo theksoi se vitet e fundit çmimi ka qenë brenda kufijve të ngjashëm. Sipas llojit të procedurës, do të kryhet një proces negociimi pa publikuar njoftim, gjatë të cilit komisioni do të negocion me operatorin ekonomik, pas së cilës do të përcaktohet nëse do të arrihet një ulje e mundshme e shumës së ofruar. Kontrata që do të rezultojë nga ky furnizim publik do të nënshkruhet (lidhet) për periudhë prej një viti.

Këshilltarja Zirjeta Jajaga pyeti nëse mund të kërkohej një shumë më e madhe mjetesh (fondesh) dhe sa mund të ishte kjo kërkesë.

Udhëheqësja Mitrevska shpjegoi se, nëse operatori ekonomik kërkon shumë më të lartë, do të zbatohen dispozitat e Ligjit për furnizim publik për mjete shtesë, me kusht që të përmbushen kriteret ligjore. Megjithatë, siç theksoi ajo, zakonisht nuk tejkalohet shuma e planifikuar, sepse në vitet e mëparshme negociatat me këtë operator ekonomik nuk kanë treguar ndonjë devijim të rëndësishëm, as një rritje të ndjeshme të çmimit. Prandaj, pritet që mjetet e planifikuara të jenë të mjaftueshme për të lidhur kontratën për furnizim publik.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për të kryer procedurë për furnizim publik-shërbim: mirëmbajtje parandaluese dhe adaptive të softuerit të integruar për çështje juridike, financiare dhe ekonomike.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: mirëmbajtje parandaluese dhe adaptive e softuerit të integruar për çështje juridike, financiare dhe ekonomike, është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, nr. 05-5639/1 datë 26.12.2025, ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026.

Pika 5

Drejtori Trajçevski shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimi - mirëmbajtje të instalimi spërkatës të zjarrit (nënstacion i thatë, spërkatës dhe pompa) dhe mirëmbajtje të aparateve për fikjen e zjarrit. Ai shpjegoi senë objektin zyrtar janë instaluar aparate kundër zjarrit, ndërsa në bodrume ka instalim spërkatësi me sistem për fikjen e zjarrit. Detyrimi ligjor i Agjencisë është të sigurojë mirëmbajtje të rregullt të këtyre sistemeve, me qëllim që të sigurohet funksionimi i tyre i qetë dhe i sigurt. Drejtori theksoi se furnizimi publik do të zbatohet si furnizim në grup, së bashku me Ministrinë e Sportit.

Kryetari Stefanovski vuri në dukje se, sipas shpjegimit, ky furnizim publik po zbatohet së bashku me Ministrinë e Sportit.

Drejtori Trajçevski sqaroi se objektet zyrtare të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Ministrisë së Sportit ndodhen në të njëjtën ndërtesë, prandaj shuma e mjeteve do të shpërndahet në pajtim me përqindjen e përdorimit të objektit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: mirëmbajtjen e instalimi spërkatës të zjarrit (nënstacion i thatë, spërkatës dhe pompa) dhe mirëmbajtjen e aparateve fikësve të zjarrit për periudhë prej 2 (dy) vitesh.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën e shërbimit: Mirëmbajtja e instalimi spërkatës të zjarrit (nënstacion i thatë, spërkatës dhe pompa) dhe mirëmbajtja e aparateve për shuarjen e zjarrit është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, nr.05-5639/1 datë 26.12.2025, ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026, përkatësisht do të parashikohen në Planin Financiar për vitin 2027

Pika 6

Të ndryshme

Kryetari Stefanovski kërkoi informacion në lidhje me ashensorin, i cili për një kohë të gjatë ka qenë jashtë funksionit.

Drejtori Trajçevski informoi se mirëmbajtja e ashensorëve kryhet përmes operatori të përzgjedhur ekonomik përmes furnizimi publik. Kompania e mëparshme, e cila instaloj pajisjet elektronike, posedon kodin e nevojshëm për ndërhyrje, prandaj operatori i sapozgjedhur nuk mund ta kryejë riparimin. Agjencia është në komunikim të vazhdueshëm me shkrim me

kompaninë, dhe po zhvillohet me vështirësi, dhe nëse nuk gjendet një zgjidhje, është e mundur që procedura të vazhdojë përmes gjykatës.

Kryetari Stefanovski theksoi se riparimi është i nevojshëm për funksionimin pa pengesa të procesit të punës.

Drejtori Trajçevski theksoi gjithashtu rrezikun e mbingarkesës së ashensorit të dytë.

Këshilltarja Zirjeta Jajaga pyeti nëse kompania ishte në dijeni të pasojave të mundshme ligjore, të cilave drejtori iu përgjigj pozitivisht, duke shpjeguar se në pajtim me ligjin, riparimi mund të kryhet vetëm nga operatori i sapozgjedhur.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Përktheu: Antoneta Shabani